

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Teori e mësimit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	I obliguar
Viti i studimeve:	I dytë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Hatixhe Ismajli
Detajet kontaktuese:	hatixheismajli@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	
	Kursi trajton konceptet themelore didaktike, veçoritë e mësimit dhe mësimdhënies; të nxënit, teoritë e të nxënit, mësimdhënien konstruktiviste; planin dhe programin mësimor, Kurrikulën e re të Kosovës, fushat, kompetencat dhe rezultatat e të nxënit; metodat dhe format e organizimit të punës mësimore, strategjitë e reja dhe teknikat e mësimdhënies, planifikimin në mësim, artikulumin e orës mësimore, objektet dhe mjetet mësimore, kontrollimin dhe vlerësimin e nxënësve .
Qëllimi i lëndës	
	Kursi ka për qëllim: 1. të sqarojë konceptet bashkëkohore didaktike; 2. të aftësojë për zbatimin e strategjive të reja, teknikave, metodave dhe formave mësimore; 3. të ndërtojë shkathtësi për planifikim vjetor dhe ditor sipas KKK; 4. të reflektojë për organizimin bashkëkohor të mësimdhënies dhe të nxënit; 5. të analizojë personalitetin e arsimtarit dhe rëndësinë e zhvillimit profesional.
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	Studentët do të jenë në gjendje: 1 të argumentojnë përparësitë e zbatimit të metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies; 2. të demonstrojnë shkathtësi për zbatimin e pikëpamjeve konstruktiviste të të nxënit; 3. të reflektojnë për format dhe strategjitë e reja mësimore që ndikojnë në aftësimin profesional të mësimdhënësve.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14	14
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	30'	14	7
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	35'	14	8.16
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1.5	14	21
Përgaditja përfundimtare për provim	1.5	14	21
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	35'	14	8.16
Projektet,prezentimet ,etj	30	14	7
Totali		14	128.32 – 5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezentimi. Kursi zhvillohet në mbështetje të mësimit interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimdhënies, duke ju dhënë vazhdimisht hapësirë për pyetje dhe diskutime. Studentët janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e dhëna dhe të prezentojnë në grup.		

Metodat e vlerësimit:	Vlerësohet: vijimi i rregullt 5%
	angazhimi në diskutime 15%
	detyrat, punimet, esetë 20%
	provimi final 60%
Literatura	
Literatura bazë:	Nijazi Zylfiu (2001). Didaktika, Prishtinë Xheladin Murati (2002). Didaktika, Metodologji e emësimdhënies, Tetovë Bardhyl Musai (2014). Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë Anita Woolfolk (2011). Psikologji edukimi, Tiranë Hatixhe Vojka-Ismajli (2012). Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik, Prishtinë
Literatura shtesë:	Sofokli Garo (2011). Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies), Tiranë Grup autorësh (2009). Si të shkruajmë objektivat mësimore për mësimdhënien dhe vlerësimin, Tiranë, Qendra për arsim demokratik
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	1. Përshkrimi i kursit/syllabusit. Dhënja e detyrave
<i>Java e dytë:</i>	2. Konceptet themelore didaktike (arsimi, mësimi, të nxënit, mësimdhënia)
<i>Java e tretë:</i>	3. Teoritë e të nxënit – Teoria konstruktiviste
<i>Java e katërt:</i>	4. Faktorët subjektivë të mësimi (nxënësi, arsimtari, familja)
<i>Java e pestë:</i>	5. Faktorët objektivë të mësimi (plani dhe programi mësimor). Kurrikula mesimore dhe korniza kurrikulare
<i>Java e gjashtë:</i>	6. Metodat mësimore dhe teknikat e mësimdhënies

<i>Java e shtatë:</i>	7. Strategjitë dhe format e punës mësimore
<i>Java e tetë:</i>	8. Objektet dhe mjetet mësimore
<i>Java e nëntë:</i>	9. Artikulimi (organizimi) i orës mësimore
<i>Java e dhjetë:</i>	10. Kurrikula bërthamë për arsimin fillor dhe Kurrikula zgjedhore
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	11. Fushat, kompetencat dhe rezultatet e të nxënit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	12. Planifikimi i mësimi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	13. Detyra praktike: Planifikimi sipas KKK
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	14. Kontrollimi dhe vlerësimi i nxënësit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	15. Reflektim: Personaliteti i mësimdhënësit. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala;
- Asnjëri nuk ka të drejtë t’i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;
- Lejohet “zhurma” e punës kur studentët punojnë në grupe;
- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezentohet puna e studentëve;
- Nuk lejohen telefonat celularë;
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme;
- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit.

